



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1966 prot.

Himarë, 21.04 .2022

NJOFTIM

Lënda : Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Himarë.

I/E nderuar këshilltar/e.

Ju njoftoj se ditën e enjte, datë 28.04. 2022, ora 10.00 paradite në sallën e stadiumit “Petro Ruci” Himarë do të zhvillohet mbledhja e radhës për muajin prill, e Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 53 pika 4, sipas kushteve të masave anti-covid me këtë rend dite:

- 1-Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2022”.
- 2-Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për transferimin në pronësi të ujësjellës kanalizime Himarë, SH.A investimin me objekt “ Ujësjellësi i fshatit Tërbaç, loti 1” Që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në njësinë Horë – Vranisht”.
- 3- Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për ridërgimin me dokumentacionin mbështetes të vendimit të Këshillit Bashkiak nr 17,datë 30.03.2022 “ Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës për përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë së trojeve te shtetaseve subjek te vendimit të Këshillit të Ministrave nr 329 ,datë22.05.2019 “ Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me agjencinë shtetërore të kadastrës për regjistrimin e trojeve ,të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje ,për efekt regjistrimi”,sipas kërkesës së prefektit të qarkut Vlorë, me shkresën nr 305/1 PROT,darë 11.04.2022.
- 4-Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për propozim për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondet e Bashkisë, për perjudhën 1 – 30 prill 2022”.
- 5-Analizë vjetore e Policisë Bashkiake Himarë për vitin 2021.
- 6-Informacion mbi raportin përfundimtar të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit,të ushtruar në subjektin Bashkia Himarë per perjudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019 deri më datë 31.05.2021.
- 7-Të ndryshme.

**Me respekt!**

SEKRETARI  
Elena Memushaj

